



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21.02.2025

Nr: 134

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR. 34 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË  
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 21.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Zj. Anduela Ristani**  
Kryetare e Bashkisë Tiranë (në mungesë dhe e komanduar)

**OBJEKT:** Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht nxjerrja e akteve që synojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë dhe përdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 34 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon: “Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve të shumta në media se Bashkia Tiranë ka shpallur fitues të fazës së parë të programit për subveccionimin të kredive të lehtësuara nga shtetit, 2,337 aplikantë .

Data: 21.02.2025

Nr: 134  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 34 ID, datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

*Qëllimi i shpalljes së fituesëve në një kohë kur po afrojnë zgjedhjet i shërben interesave politike që mbështet dhe përfaqëson Bashkia Tiranë. Gjithashtu bazuar në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, nxerrja e akteve të cilat sigurojnë dhënien e përfitimeve në favor të individëve të caktuar është veprimtari publike e ndaluar.”*

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Zj. Anduela Ristani, Kryetare e Bashkisë Tiranë *(në mungesë dhe komanduar)*.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**